



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 698 Akti**

**Nr. 631 Vendimi**  
**Tiranë, më 3.3.2023**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	Kryesuese
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 2.3.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Aida Cakaj**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Znj. Aida Cakaj, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 15.12.2020, zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykuese, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Aida Cakaj do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Aida Cakaj nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Aida Cakaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Aida Cakaj.

**12.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 20.2.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; dhe (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes.

**15.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 22.2.2023, u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit nuk ushtroi të drejtën e saj për t'u njohur me aktet e dosjes, ndërsa më datë 27.2.2023 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\* , datë 14.10.2022, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2023.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

## II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 28.2.2023.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 2.3.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

19. Subjekti i rivlerësimit Aida Cakaj mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Aida Cakaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>5</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

---

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 28.2.2023.

<sup>5</sup> "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: 'Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit'. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se 'Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë'. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse".

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) gjetjet dhe opinionin e paraqitura me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar; dhe (g) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1 Subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën në datën 13.11.2013 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

23.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si në vijim.

### 24. Të ardhurat si më poshtë:

a) Të ardhura nga paga<sup>6</sup> të grumbulluara në llogarinë e “Intesa Sanpaolo Bank” deri në datën e dorëzimit të deklaratës, në vlerën 559,658.82 lekë. Këto të ardhura janë kursyer nga subjekti nga të ardhurat që ka marrë nga paga prej fillimit të detyrës e deri aktualisht.

b) Të ardhura nga paga që kalojnë në mënyrë automatike në një llogari kursimi, që hiqen nga paga, në shumën 1,000 lekë çdo muaj, që prej kohës që është hapur kjo llogari kursimi dhe disponohen prej subjektit në vlerën 10,142.55 lekë në datën e dorëzimit të deklaratës. Kjo shumë ka si burim krijimi pagën e subjektit dhe normat e interesit që banka aplikon mbi shumën që është në llogarinë e kursimit.

c) Në kartën e internetit të hapur në “Credins Bank” ka mbetur shuma 194.32 lekë. Këto të ardhura burojnë nga paga e subjektit dhe janë kaluar në kartë, si dhe përdoren për blerje *online*.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhura nga paga.

---

<sup>6</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, me gjendje në datën 19.1.2017 në vlerën 559,658 lekë.

## **Hetimi<sup>7</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**24.1** Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se në datën 10.6.2014 subjekti ka çelur pranë kësaj banke llogarinë nr. \*\*\*, e cila ka shërbyer në vazhdimësi si llogari page. Në datën 23.1.2017 gjendja e kësaj llogarie rezulton në vlerën 549,658.82 lekë.

**24.2** Në “Intesa Sanpaolo Bank” subjekti rezulton të ketë çelur në datën 11.6.2014 llogarinë nr. \*\*\*, e cila shërben si llogari kursimi. Nga verifikimi i kësaj llogarie rezulton se ajo është kredituar çdo muaj me vlerën 1,000 lekë dhe gjendja e saj në datën 23.1.2017 është në vlerën 10,142.55 lekë.

**24.3** Në lidhje me kartën e debitit “V.P” në “Credins Bank”

**24.4** Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit në “Credins Bank” rezulton se në datën 29.8.2014 subjekti ka çelur pranë kësaj banke llogarinë nr. \*\*\*, e cila shërben si llogari rrjedhëse për kartën e debitit “V.P”. Në këtë llogari subjekti kryen depozitime periodike të shumave minimale, të cilat përdoren më pas për blerje *online*. Nga verifikimi i kësaj llogarie rezulton se gjendja e saj në datën 23.1.2017 është në vlerën 194.32 lekë.

**24.5** Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këto llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

**25. Automjet<sup>8</sup> tip “Fiat Punto”,** me targa AA \*\*\* NM, blerë përmes kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 15.3.2016, në vlerën 280,000 lekë.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** të ardhurat e krijuara nga paga e subjektit që ka disponuar në kohën e blerjes së automjetit.

## **Hetimi<sup>9</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**25.1** Me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 15.3.2016, të nënshkruar pranë noterit G. B, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi A.Sh automjetin tip “F.P” (vit prodhimi 2001), për çmimin 280,000 lekë. Në përmbajtje të kontratës palët deklarojnë se çmimi i shitjes është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Subjekti i rivlerësimit është pajisur me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor në datën 15.3.2016.

**25.2** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPSHTRR-ja, rezulton se shitësi A. Sh e ka blerë këtë automjet në Gjermani në datën 11.12.2015, për çmimin 850 euro dhe ka paguar vlerën 27,767 lekë për zhdoganimin e tij.

**25.3** Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2016.

**25.4** Si burim për blerjen e këtij automjeti subjekti ka deklaruar të ardhurat e krijuara nga paga e saj si prokurore. Nga verifikimi i llogarisë së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se gjendja në llogarinë nr. \*\*\*, e cila shërben si llogari page, në datën 15.3.2016 është në vlerën

---

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, drejtuar bankave të niveli të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021, e “Credins Bank”.

<sup>8</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 15.3.2016; (ii) certifikatë pronësie e mjetit rrugor, datë 15.3.2016.

<sup>9</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2021, e DPSHTRR-së.

787,920.61 lekë. Në po këtë datë subjekti ka tërhequr *cash* nga kjo llogari shumën 287,920.61 lekë, nën komentin “shpenzime”.

**25.5** Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

## **PASURITË E BASHKËJETUESIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga janari i vitit 2017 ka filluar bashkëjetesën me shtetasin A.Zh. Në deklaratën *Vetting* bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar këto pasuri:

**26. Të ardhura nga paga**<sup>10</sup> si i punësuar pranë kompanisë “A” në vlerën 55,732.09 lekë, që ndodhen në llogarinë rrjedhëse në “Veneto Bank”.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhura nga paga si i punësuar në kompaninë “A”.

### **Hetimi<sup>11</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**26.1** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëjetuesit të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se kjo llogari është migruar nga “Veneto Bank”, e cila është përthithur nga “Intesa Sanpaolo Bank”. Ajo ka shërbyer si llogari page dhe gjendja e saj në datën 22.1.2017 rezulton në vlerën 55,732.09 lekë.

**26.2** Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

### **27. Llogari kursimi në shumën 170,182.54 lekë**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhura nga paga si i punësuar në kompaninë “A” në vitin 2016.

### **Hetimi<sup>12</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**27.1** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëjetuesit të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se kjo llogari është migruar nga “Veneto Bank”, e cila është përthithur nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe ka shërbyer si llogari kursimi.

**27.2** Në datën 22.1.2017 kjo llogari me nr. \*\*\* rezulton në vlerën 170,182.54 lekë.

**27.3** Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari kursimi dhe bashkëjetuesi i subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes në këtë llogari.

### **28. Gjendje *cash* në shumën 100,000 lekë**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhura nga paga e marrë nga qershori i vitit 2013 e në vijim deri në vitin 2016.

<sup>10</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Veneto Bank”, me gjendje në datën 23.1.2017 në vlerën 55,732 lekë.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021, “Intesa Sanpaolo Bank”.

## **Hetimi<sup>13</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**28.1** Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë e bashkëjetuesit të subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën e deklaruar, nga e cila ka rezultuar se ai ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 100,000 lekë.

**28.2** Në përfundim konkludohet se bashkëjetuesi i subjektit ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për të krijuar gjendjen *cash* në shumën 100,000 lekë.

## **29. Në lidhje me vendbanimin e subjektit dhe bashkëjetuesit të saj**

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**29.1** Në seksionin “të dhëna konfidenciale” në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Përdor banesën e marrë me qira prej shtetasve F.R.S dhe Sh.N.S, ndodhur në qytetin e Fierit, lagjja ‘\*\*\*’, rruga ‘R.A’, zyra e gjendjes civile nr. \*”.

**29.2** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 10.1.2017, përmes së cilës subjekti dhe bashkëjetuesi kanë marrë me qira nga qiradhënësit F e Sh.S apartament banimi me sipërfaqe 71.34 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, kundrejt qirasë mujore 12,000 lekë.

**29.3** Në përgjigje të pyetësorit standard lidhur me adresën e banimit, subjekti ka deklaruar: “Prej kohës kur mora detyrën e deri në fillim të vitit 2017 kam banuar në lagjen ‘M.M’, Patos, në shtëpinë e prindërve. Në 10 janar 2017 është lidhur kontrata e qirasë për banesën që ndodhet në qytetin e Fierit”.

**29.4** Në deklaramet vjetore të viteve 2013 – 2016 subjekti ka deklaruar si adresë banimi banesën në lagjen “M.M”, Patos. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë banimi banesën në lagjen “\*\*\*\*” në qytetin e Fierit.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, rezulton se babai i subjektit, z. B.C, e ka blerë banesën 1-katëshe të ndodhur në lagjen “M.M”, Patos, përmes kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 27.11.1998, për çmimin 1,500,000 lekë.

**29.5** Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit me qiradhënësit e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, Komisioni ka mbajtur korrespondencë<sup>14</sup> me institucionin punëdhënës të subjektit të rivlerësimit, i cili në përgjigjen e tij konfirmon se nuk rezultojnë çështje të hetuara nga kjo prokurori në ngarkim të shtetasve F dhe Sh.S.

**29.6** Referuar dokumentacionit hipotekor, që i bashkëlidhet kontratës së qirasë, rezulton se shtetasit F dhe Sh.S janë pronarë të kësaj pasurie nga viti 2006. Gjithashtu, referuar informacionit të gjeneruar nga sistemi elektronik i ASHK-së, rezulton se aktualisht ata vijnë të jenë pronarë të kësaj pasurie.

**29.7** Nga motori i kërkimit në *google* nuk rezultojnë të dhëna për përfshirjen e shtetasve F dhe Sh.S në krimin e organizuar.

**29.8** Në përfundim konkludohet se nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me vendbanimin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetuesit të saj.

<sup>13</sup> Vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, paraqitur nga subjekti së bashku me deklaratën *Vetting*.

<sup>14</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.



### **30. Në lidhje me pasuritë e llojit “arë” të përfituara me AMTP nga babai i bashkëjetuesit, z. K.Zh**

#### **Hetimi<sup>15</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**30.1** Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se në emër të babait të bashkëjetuesit, z. K. Zh, figuron e regjistruar pasuria e paluajtshme e llojit “arë”, me sip. 3352 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Libohovë, Gjirokastrë.

**30.2** Nga shqyrtimi i AMTP-së datë 31.7.1996, të vënë në dispozicion nga ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastrë, rezulton se shtetasi K.Zh ka përfitur në cilësinë e kryefamiljarit pasuritë arë me sip. 8200 m<sup>2</sup> dhe arë me sip. 3200 m<sup>2</sup>, nga të cilat rezulton e regjistruar në regjistrat hipotekorë vetëm sipërfaqja e tokës arë 3352 m<sup>2</sup>.

**30.3** Referuar përcaktimeve të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pavarësisht se toka e përfitur përmes këtij ligji regjistrohet në emër të kryefamiljarit të familjes bujqësore, ajo i përket anëtarëve të familjes që rezultojnë në certifikatën e përbërjes familjare të datës 1.8.1991.

**30.4** Referuar datëlindjes<sup>16</sup> së bashkëjetuesit të subjektit, rezulton se në vitin 1996, vit kur janë përfitur pasuritë arë përmes AMTP-së, ai ka qenë anëtar i familjes bujqësore të kryefamiljarit K.Zh.

**30.5** Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së personit të lidhur rezulton se bashkëjetuesi i subjektit nuk ka deklaruar pjesën takuese që disponon në pasuritë arë të përfituara me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, si anëtar i familjes bujqësore të kryefamiljarit K.Zh.

**30.6** Në lidhje me mosdeklarimin e pjesëve takuese të këtyre pasurive, në shpjegimet e parashtruara në seancë dëgjimore subjekti deklaroi se ajo dhe bashkëjetuesi janë vënë në dijeni të faktit të regjistrimit të pasurisë arë në ASHK vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit. Subjekti pohoi së bashkëjetuesi i saj nuk ka kryer asnjë veprim apo aplikim për regjistrimin e këtyre pasurive dhe as nuk i ka përdorur apo poseduar ato.

**30.7** Në analizë të rrethanave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, Komisioni vëren se pasuritë e llojit “arë” janë krijuar nga babai i bashkëjetuesit të subjektit në cilësinë e kryefamiljarit të familjes bujqësore, në vitin 1996, kohë në të cilën shtetasi A.Zh ka qenë në moshë të mitur. Për më tepër rezulton se bashkëpronësia mbi këto pasuri është fituar nga personi i lidhur disa vite para fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit, jo si pasojë e shfaqjes së vullnetit të tij, por si pasojë e parashikimeve të një ligji të posaçëm.

**30.8** Për sa më sipër, në kushtet kur nuk ka dyshime mbi mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të pasurive të llojit “arë”, trupi gjykues, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>17</sup>, çmon se mosdeklarimi i këtyre pasurive nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, përbën pasaktësi në deklarim me peshë specifike të tillë që nuk ndikon në vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit. Kjo pasaktësi nuk mund të ngrihet në atë nivel sa të kualifikohet sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës apo për pamjaftueshmëri në deklarim, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastrë.

<sup>16</sup> A.Zh, datëlindja 29.3.1986.

<sup>17</sup> Vendimi nr. 202/2020 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paragrafët 17-17.5.

## **Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**31.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**32.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Aida Cakaj nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**33.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Aida Cakaj ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**34.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Aida Cakaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

**35.** Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>18</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Aida Cakaj, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**36.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Ky qëndrim nuk ka ndryshuar edhe pas përditësimit të raportit nga ana e DSIK-së<sup>19</sup>.

**37.** Komisioni kreu një hetim<sup>20</sup> të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit Aida Cakaj. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

## **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

<sup>18</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*, datë 6.1.2021, të KDZH-së.

<sup>19</sup> Raporti i përditësuar me nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.8.2022, të KDZH-së.

<sup>20</sup> Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

**38.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Aida Cakaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**39.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

#### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë**

**40.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**41.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së.

**42.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**43.** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk u konstatuan problematika.

**44.** Nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short subjektit iu kërkuan shpjegime për dosjen nr. 1.

**Dosja nr. 1** – kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 18.7.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Objekti i shortit: dokumenti ligjor - vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 16.10.2014, për kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 18.7.2014, për veprën penale “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor - vendim është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse; pjesa përshkuese - arsyetuese; dhe dispozitivi. Subjekti i rivlerësimit paraqet analizën e provave. Kundërshtimi i pretendimeve të shfaqura nga kallëzuesi kryhet duke iu referuar provave në fashikull. Në pjesën e dispozitivit subjekti parashtron disponimin e saj, duke u bazuar në germën “ç” të nenit 290/1 dhe në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkuese - argumentuese dhe përfundon me dispozitivin për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Nga përmbajtja e tij konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.

Teksti është i qartë dhe i kuptueshëm. Përgjithësisht akti është i arsyetuar. Në këtë vendim konkluzioni i prokurores, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

**45.** Në përfundim të analizimit të këtij rasti, KLP-ja ka konkluduar se vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar”, i Prokurorit të Përgjithshëm. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

**46.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, në prapësimet e paraqitura subjekti shpjegoi se në marrjen e vendimit jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm kanë ndikuar disa shkaqe, ku shkaku kryesor i dokumentuar edhe në dosje është mbërritja me vonesë e aktekspertimit vlerësues-ekonomik lidhur me vlerën e dëmit të shkaktuar. Fakti që aktekspertimi ekonomik ka mbërritur me vonesë dokumentohet në faqen nr. \*\* të dosjes, ku aktekspertimi ka hyrë në protokoll me nr. \*\*\*, në datën 16.10.2014, si dhe provohet nga shënimi mbi këtë aktekspertim që ka kryer Drejtuesi i Prokurorisë, shënim që mban datën 16.10.2014. Data e mbërritjes me vonesë të këtij akti rezulton e pasqyruar edhe në vetë vendimin e mosfillimit të procedimit penal, vendim i cili është marrë po në ditën e mbërritjes së këtij akti.

**47.** Komisioni, pasi vlerësoi prapësimet e subjektit në lidhje me këtë dosje, çmon se mosrespektimi i afatit 30-ditor në vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal, ka qenë i kushtëzuar nga vonesa e shkaktuar nga administrimi i aktekspertimit nga eksperti i pavarur. Vendimi i subjektit të rivlerësimit për kryerjen e ekspertimit vlerësues rezultoi të jetë hartuar nga subjekti në të njëjtën datë që i është caktuar për ndjekje ky procedim penal. Gjithashtu, nga aktet e fashikullit penal rezultoi se vendimi i subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal është marrë në të njëjtën datë me mbërritjen e aktit.

Nga sa më sipër, argumentet e subjektit në lidhje me shpjegimet e kërkuara duken bindëse.

### **Të dhëna nga burime arkivore të KLP-së lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime**

**48.** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se subjekti Aida Cakaj nuk ka pasur masa disiplinore.

Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar dy kallëzime penale, një në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020, dhe një në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2021, si vijon:

- Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 26.11.2018, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, pas shqyrtimit të materialit kallëzues dhe administrimit të dosjes hetimore, në datën 26.12.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

- Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 1.3.2019, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pas shqyrtimit të materialit kallëzues dhe administrimit të dosjes hetimore, në datën 21.3.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila, me vendimin nr. \*\*, datë 20.5.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit.

**49.** Ndaj subjektit të rivlerësimit ka tri ankesa të regjistruara në Prokurorinë e Përgjithshme, si vijon:

- Ankesa nr. \*\*\* e vitit 2018, e shtetasit H.K, e marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2018, ka sqaruar ankuesin se pas njohjes me pretendimet e tij në kushtet kur çështjet aktualisht po shqyrtohen në Gjykatën e Apelit, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe praktikës së konsoliduar gjyqësore, është kjo gjykatë që do të shqyrtojë dhe vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga prokuroria.

- Ankesa nr. \*\*\* e vitit 2018, e shtetasit Rr.L, e marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, e cila ankesën e këtij shtetasi e ka dërguar për kompetencë dhe zgjidhje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke vënë në dijeni edhe ankuesin Rr.L. Kjo çështje penale është analizuar edhe në seksionin “Denoncime”.

- Ankesa nr. \*\*\* e vitit 2019, e shtetasit S.Xh, e marrë në shqyrtim nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, ku pas shqyrtimit është vendosur arkivimi i kërkesës, me arsyetimin se nga verifikimi i praktikës dhe, siç shprehet edhe ankuesi, rezulton se kjo kërkesë e prokurorit është pranuar nga gjykata dhe të gjitha pretendimet duhet t’i drejtonte gjatë procesit gjyqësor. Kjo çështje penale është analizuar edhe në seksionin “Denoncime”.

## **DENONCIME**

**50.** Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 3 denoncime të paraqitura në Komision, si dhe 1 denoncim mediatik. Pas analizimit<sup>21</sup> të dokumentacionit të administruar rezulton se në të gjitha denoncimet nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

### **Konkluzion i Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

**51.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

**52.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe konsiderohet “e aftë” në aspektin profesional.

**53.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>21</sup> Për më tepër shihni rezultatet e hetimit administrativ.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aida Cakaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 03.03.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela ZHEGU**  
**Kryesuese**

**Roland ILIA**  
**Anëtar**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*